



Bilanci Kombëtar i Energjisë 2020

Agjencia Kombetare e Burimeve Natyrore

Tiranë 2021

Autorët:

Artan Leskoviku, AKBN

Renata Aliko, AKBN

Evis Cano, AKBN

Teuta Thimjo, AKBN

Valentina Hita, AKBN

Elvis Jorgji, AKBN

Kostanca Rexhepi, AKBN

PERMBAJTJE

PERMBAJTJE	3
1. HYRJE	1
2. ZHVILLIMET MAKROEKONOMIKE	2
2.1 Të dhënat makroekonomike	5
2.2 Ecuria e aktivitetit ekonomik	7
2.3 Inflacioni	8
3. AKBN - AGJENCIA KOMBETARE E BURIMEVE NATYRORE	10
4. BILANCI ENERGJETIK	13
5. PRODUKTET PRIMARE	14
5.1 Nafta dhe Gazi	14
5.2 Qymyri	18
5.3 Prodhimi i Energjisë Elektrike	18
5.3.1 Prodhimi	20
5.3.2 Kapacitetet dhe Prodhimi i Energjisë Elektrike	24
5.3.3 Gjendja e TEC-it Vlorë.	24
5.3.4 Prodhimi nga HEC-et Private/Koncesion të Energjisë Elektrike	25
5.3.5 Prodhimi nga impiantet fotovoltaike	26
5.4 Konsumi i energjisë elektrike	27
5.4.1 Struktura e Konsumit të Energjisë Elektrike	27
5.4 Import – Eksport	29
5.6 Humbjet e energjisë elektrike	30
5.7 Hidroenergji	36
5.8 Energjia e Rinovueshme në Bilancin e Energjisë	38
5.9 Drutë e Zjarrit	39
5.10 Biokarburantet	40
5.11 Energjia Diellore	40
5.12 Energjia e erës	41
6. TRANSFORMIMI	42
6.1 Energjia Hidrike	42
6.2 Rafineritë	42
7. KONSUMI	42
7.1 Sektori i industrisë	42
7.2 Sektori i transportit	43
7.3 Sektori i banesave	45
7.4 Sektori i shërbimeve	45
7.5 Sektori i bujqësisë	46
8. ANEKS Bilanci Energjetik 2020	47

1. HYRJJE

Pandemia COVID-19 dominoi zhvillimet ekonomike të vitit 2020. Masat e marra për frenimin e saj dhe rritja e pasigurisë shkaktuan rënie të kërkesës e të prodhimit, rritje të papunësisë, dhe vështirësi financiare për bizneset dhe familjet shqiptare. Në këtë kontekst ekonomik, presionet inflacioniste mbetën të ulëta dhe inflacioni qëndroi poshtë objektivit 3%.

Politikat ekonomike fiskale, monetare, financiare reagueshan në kohë dhe në mënyrë të koordinuar. Politika monetare u bë më stimuluese. Stimuli monetar ndihmoi funksionimin e mirë të tregjeve financiare, uljen e normave të interes dhe të primeve të rrezikut, si dhe në mbështetjen me kredi bankare të familjeve dhe bizneseve shqiptare në një kohë pasigurie.

Masat e marra kontribuan në zbutjen e pasojave të pandemisë për bizneset dhe familjet shqiptare dhe në ruajtjen e stabilitetit monetar e financiar, duke krijuar premisa për një rimëkëmbje sa më të shpejtë të ekonomisë. Ky është një parakusht i nevojshëm për kthimin e inflacionit në objektivin tonë 3%. Politika monetare do të ruajë kahun e saj stimulues në afatin e mesëm, duke ndihmuar rritjen e qëndrueshme ekonomike dhe kthimin e inflacionit në objektiv.

Viti 2020 ishte një vit i vështirë për ekonominë botërore dhe atë shqiptare. Me shume se 90% e ekonomive të globit regjistruan rënie ekonomike, rritje të papunësisë dhe presione të dobëta inflacioniste. Treguesit e balancave kryesore ekonomike u përkeqësuan dhe deficitet fiskale dhe borxhet publike shënuan rritje të shpejtë. Në përgjigje të tyre, autoritetet publike kanë marrë masa të paprecedenta fiskale dhe monetare, duke lehtësuar impaktin e pandemisë dhe duke rritur shanset për një rikuperim të shpejtë të aktivitetit ekonomik me përfundimin e saj.

Sipas Institutit të Statistikave, aktiviteti ekonomik në vend u tkurr me 5.5%, punësimi ra me 1.2% dhe shkalla e papunësisë u rrit në 11.6%, gjatë tre tremujorëve të parë të vitit. Rënia ekonomike pasqyroi kontraktimin e njëkohshëm të thujasë të gjithë përbërësve të kërkesës agregate dhe të të gjithë sektorëve të ekonomisë. Kriza goditi në mënyrë të veçantë flukset tregtare dhe sektorin e shërbimeve, si aktivitetet më të ekspozuara ndaj kufizimeve të vendosura. Nga ana tjetër, rritja e stimulit fiskal kompensoi pjesërisht rënien e konsumit dhe të investimeve private. Rënia

ekonomike tkurri të ardhurat fiskale, të cilat, të kombinuara me rritjen e shpenzimeve, sollën rritjen e shpejtë të deficitit fiskal dhe të borxhit publik. Ky i fundit, arriti në 77.8% të PBB-së në fund të vitit 2020, nga 66.2% në fund të vitit 2019.

Në terma të dinamikës kohore, ndikimi më i madh i pandemisë u materializua në tremujorin e dytë. Më tej, relaksimi i kufizimeve i hapi rrugë një rikuperimi gradual dhe të pjesshëm të aktivitetit ekonomik dhe të tregut të punës. Megjithatë, si prodhimi ashtu edhe punësimi mbeten në nivele më të ulëta në raport me vitin 2019 dhe kapacitetet prodhuese të pashfrytëzuara janë rritur. Për pasojë, presionet inflacioniste vijnë të jenë të ulëta.

Sigurisht që viti 2020, ka qenë, në aspektin ekonomik dhe të financave publike, një ndër vitet më të vështira në tre dekada të fundit, më saktësisht më i vështiri që prej vitit '97. Rrjedhimisht mjaft sfidues për menaxhimin e situatës nëpërmjet politikave dhe instrumentave që disponon një shtet, si politika fiskale dhe monetare. Shqipëria, përveç tronditjes nga pandemia që vuajti e gjithë bota, pak përpara saj u godit edhe nga tërmeti, e sigurisht impakti negativ në ekonomi ishte i amplifikuar.

Sidoqoftë, megjithë ndikimin e rëndë që të dy goditjet kanë patur për ne, mund të them që, për shkak të përgjigjeve relativisht mjaft të mira të politikave ekonomike, fiskale e monetare, të gjitha statistikave dhe shenjat që disponojmë deri më tani dëshmojnë se situata e përgjithshme në mbyllje të vitit 2020 dhe aktualisht që flasim relativisht më e mirë se sa pritej prej shumë prej nesh, si institucionet vendase, ashtu edhe ato ndërkombëtare. Kjo, pavarësisht kohës sfiduese që po kalojmë, shërben disi një lajm inkurajues dhe gjithashtu përbën një test real, konkret, të aftësisë absorbuese dhe adaptuese të ekonomisë sonë kundrejt këtyre lloj goditjesh, me të tilla magnituda.

2. ZHVILLIMET MAKROEKONOMIKE

Nga pikëpamja makroekonomike, është fakti se megjithë atë që kaluam gjatë vitit të kaluar, kur patëm një prej recesioneve më të ashpra në dekada, si dhe pavarësisht disa përkeqësimeve të konsiderueshme në parametrat kryesorë makroekonomikë dhe veçanërisht fiskalë, duket se fondamentet kryesore të ekonomisë dhe financave, si dhe stabiliteti i përgjithshëm

makroekonomik i vendit i ka rezistuar relativisht mirë goditjeve, në krahasim me shqetësimet fillestare që kishim.

Tkurrja e PBB -së për shkak të pandemisë arriti kulmin në tremujorin e dytë në rreth minus -**11%** dhe tremujori i fundit e riktheu ekonominë në terren pozitiv. Ndërsa i gjithë viti 2020 regjistroi një recension prej minus -**4%**, i cili edhe pse është recension i dytë më i fortë që ekonomia ka përjetuar në tre dekada, sërisht është me rëndësi fakti se ky recension ishte shumë më i përmbajtur sesa pritjet fillestare të institucioneve të ndryshme, vendase dhe ndërkombëtare, që varionin nga rreth -**6%** deri në rreth -**8%**.

Gjithashtu, implikimet në tregun e punës deri më tani nuk duket të kenë qenë shqetësuese, veçanërisht në lidhje me implikimet strukturore afatgjata për këtë të fundament të ekonomisë. Kjo, patjetër në një masë të konsiderueshme i atribuohet edhe disa masave adekuate që u ndërmorën nga qeveria gjatë muajve të mbylljes totale për të paguar punonjësit dhe për të ruajtur masën dërmuese të vendeve të punës.

Pozicioni i jashtëm i ekonomisë, një tjetër fundament tejet i rëndësishëm dhe tipikisht vulnerabël përballë goditjeve të tilla, mbeti relativisht solid. Tkurrja e mprehtë e eksporteve të mallrave dhe shërbimeve gjatë vitit 2020 duket se është kompensuar nga pesha e lartë strukturore e importeve të mallrave dhe shërbimeve, të cilat u tkurrën mjaft fort. Sigurisht që edhe remitancat u tkurrën ndjeshëm. Pra, ne kemi pasur një zgjerim të deficitit të llogarisë korente, por jo në një shkallë serioze shqetësuese dhe të paqëndrueshme. Bilanci i përgjithshëm i pagesave dhe niveli i rezervave ndërkombëtare të vendit është mbajtur mjaft mirë, në fakt është përmirësuar gjatë 2020, dhe kjo krejtësisht në të kundërt me frikën tonë fillestare për implikimet në këtë fundament të ekonomisë. Teprica pozitive në bilancin e pagesave ishte kryesisht për shkak të flukseve hyrëse financiare që u mundësuan në formën e huamarrjes së jashtme të qeverisë, qoftë si huamarrje koncesionare nga partnerët tanë kryesorë ndërkombëtarë (FMN, Komisioni Evropian, Banka Botërore dhe të tjerë) të cilët na kanë ardhur menjëherë në ndihmë me kredi të buta dhe të shpejta, ashtu edhe huamarrje komerciale, ku arritëm të emetojmë një eurobond relativisht mjaft të suksesshëm në qershor të vitit 2020, në pikun e pandemisë. Këto flukse hyrëse, që u injektuan në ekonomi përgjatë goditjes, kanë kompensuar jo vetëm për zgjerimin e deficitit të llogarisë aktuale, por edhe për tkurrjen e flukseve hyrëse të IHD –ve që ndodhi gjatë 2020, gjatë pandemisë.

Qëndrueshmëria e pozicionit të jashtëm të ekonomisë u reflektua edhe në tregun valuator, ku kursi i këmbimit të Lekut kundrejt valutave kryesore mbeti relativisht stabil gjatë gjithë vitit 2020 dhe vijon të mbetet i tillë.

Një tjetër fundament i rëndësishëm i ekonomisë që gjithashtu ka mbetur përgjithësisht mjaft i qëndrueshëm është sistemi financiar dhe aktiviteti i tij i ndërmjetësimit. Ndërkohë që parametrat kryesorë të sistemit, mjaftueshmëria e kapitalit, likuiditeti apo profitabiliteti, kanë qëndruar përgjithësisht në nivele relativisht të shëndetshme. Aktiviteti i ndërmjetësimit financiar ka vijuar me ritme relativisht të kënaqshme ku kreditimi për ekonominë është rritur me 7%, ndërsa po ashtu sistemi ka vijuar të akumulojë kursime të bollshme, pra dhe depozitat kanë vijuar rritjen. Në të njëjtën kohë, niveli i kredive me probleme ndaj totalit të kredisë ka performuar mirë, edhe për shkak të politikave të ndërmarra nga Banka e Shqipërisë.

Dhe padyshim, financat publike, të cilat përbëjnë një tjetër fundament ekonomik shumë të rëndësishëm dhe në përgjithësi shumë të ekspozuar ndaj goditjeve të tilla, deri më tani duket se kanë qenë relativisht mjaft të qëndrueshme, përtej siç e përmenda më parë, përkeqësimit të konsiderueshëm të parametrave kryesorë, si deficitit apo borxhit publik, gjatë vitit të shkuar.

Në vitin 2020, deficitit i përgjithshëm fiskal kërceu në rreth **7% të PBB-së** nga një mesatare **rreth 2%** në tre vitet e mëparshme dhe borxhi publik u rrit në **76% të PBB-së**, pra me rreth **10 pikë përqindje** nga fundi i vitit 2019. Përkeqësimi i këtyre parametrave të financave publike gjatë vitit të shkuar ishte goxha i fortë, por nga ana tjetër, kjo politikë fiskale ekspansioniste ishte jo vetëm e pashmangshme, por edhe krejtësisht e nevojshme dhe adekuate me qëllim shmangien e pasojave të tjera shumë të rënda dhe me efekte negative zinxhir në ekonominë e vendit.

Për të ndërmarrë një politikë të tillë fiskale ekspansioniste, në kundërpërgjigje të goditjes, ne gjithashtu na u desh që gjatë vitit 2020 të aktivizonim “klauzolat e devijimit” nga rregullat fiskale që kemi në Ligjin Organik të Buxhetit, pra klauzola që ishin që më parë të parashikuara në këtë ligj, duke mos cënuar kështu kredibilitetin e financave publike për perceptimin e tregjeve dhe agjentëve ekonomikë.

Në raportin për ekonominë botërore, të publikuar në javën e dytë të muajit Prill, Fondi Monetar Ndërkombëtar, e karakterizon krizën ekonomike të shkaktuar nga pandemia COVID-19, si krizë që nuk e kemi parë asnjëherë më parë dhe për këtë arsye ka një pasiguri të madhe për ndikimin e saj në jetën e njerëzve. Shumica e vendeve në botë po ballafaqohen në të njëjtën kohë me krizë

shendetësore, krizë financiare dhe rënie drastike të çmimit të lëndës së parë, përfshirë naftën. Në bazë të projeksioneve të Fondit Monetar Ndërkombëtar ekonomia globale do të bjen në – 3%, që është rënie prej 6.3 pikë të përqindjes, krahasuar me projeksionet e Janarit të vitit 2020. Kjo rënie pritet të shkaktoj recesionin më negativ që e kemi parë, që nga kriza e “Depresionit të Madh” dhe shumë më negative, se sa kriza globale financiare e vitit 2008.

2.1 Të dhënat makroekonomike

Ne tabelen e mëposhteme paraqiten të dhënat makro ekonomike për vitin 2020 krahasuar me vitin 2019 në përqindje.

2020/2019	Në përqindje
Rritja nominale e PBB	-4.2
Rritja reale e PBB	-3.3
Rritja e PBB për frymë në lekë	-4.0
Inflacioni mesatar vjetor	1.6
Inflacioni fund viti	1.1
Norma e papunësisë (15 vjec e lart)	11.8
Rritja e eksporteve të mallrave	-9.0
Eksportet (në % të PBB)	6.0
Rritja e importeve të mallrave	-6.8
Importet (në % të PBB)	-27.1
Bilanci i llogarisë korrente (në % të PBB)	-9.2

Gjatë tre mujorit të parë të vitit 2020, Investime direkte të huaja në vend arritën në -9.3 milion euro dhe regjistruan dalje neto në vlerë prej -19.2 milion euro krahasuar me tremujorin e dytë të vitit paraprak. Dalja është rezultat i zvogëlimit të borxhit brenda ndërmarrjeve, për shkak të

zmadhimit të investimeve në ekuitet dhe reinvestim të fitimit të ndërmarrjeve. Shikuar kumulativisht, në gjysmë vitin e par të vitit 2020, Investime direkte te huaja në vend janë 122.6 milionë euro. Rënia e investimeve vlerësohet të ketë pasqyruar kontraktimin e investimeve private, në një kohë kur investimet publike erdhën në rritje. Ecuria negative e investimeve nisi gjatë tremujorit të fundit të vitit 2019 dhe u intensifikua gjatë gjysmës së parë të vitit 2020, në linjë me vendosjen e kufizimeve, rënien e kërkesës konsumatore dhe rritjen e pasigurisë. Nga ana tjetër, aktivizimi i programit të rindërtimit të objekteve të shkatërruara nga tërmeti u pasqyrua në rritjen e investimeve publike. Tregues sasiore paraprakë dhe rezultatet e përfutuara nga vrojtimet sugjerojnë se investimet do të vijojnë të kontribuojnë pozitivisht në rritjen ekonomike të tremujorit të katërt. Normat e ulëta të interest dhe rritja e kredisë për qëllime investime janë faktorë favorizues.


Tabela1. Treguesit kryesorë makroekonomikë dhe financiarë

	2016	2017	2018	2019	2020*
Inflacioni (mesatar)					
Inflacioni total (në %)	1.3	2.0	2.0	1.4	1.6
Inflacioni bazë (në %)	0.2	0.8	0.9	0.7	1.4
Rritja ekonomike					
Rritja reale e PBB-së (vjetore në %)	3.3	3.8	4.1	2.2	-5.5
Tregu i punës					
Shkalla e pjesëmarrjes në forcën e punës (15-64 vjeç)	66.2	66.8	68.3	69.6	69.2
Norma e papunësisë (15-64 vjeç)	15.2	13.7	12.3	11.5	11.6
Spektori fiskal					
Balanca buxhetore (me grantet, % të PBB)	-1.8	-2.0	-1.6	-1.9	-6.9
Të ardhurat buxhetore (në % të PBB-së)	27.6	27.7	27.4	27.3	26.7
Shpenzimet buxhetore (në % të PBB-së)	29.4	29.7	29.0	29.2	0.50
Borxhi publik (në % të PBB-së)**	72.3	70.1	67.8	66.5	77.8
Spektori i jashtëm					
Llogaria korrente (përfshirë transferatat zyrtare, në % të PBB-së)	-8.0	-8.1	-7.3	-8.5	-8.9
Importet në mallra (fob, në % të PBB-së)	30.9	31.3	30.0	29.7	28.2
Eksportet në mallra (fob, në % të PBB-së)	6.7	6.9	7.7	6.6	5.9
Investimet e huaja direkte (% PBB-së)	8.8	7.8	7.9	7.9	7.3
Spektori monetar e financiar					
Norma e repos (fund periudhe)	1.25	1.25	1.00	1.00	0.5
Agregati M3 (rritje vjetore, fund periudhe)	3.9	0.3	-0.2	4.3	10.5
Kredia për sektorin privat (rritje vjetore, fund periudhe) ²	3.1	3.3	1.9	6.9	8.2
Depozita/PBB-së ³	74.2	71.4	68.7	70.4	80.2
Kredi/PBB-së ³	37.1	36.4	35.3	36.5	41.7
Yieldi 12-mujor (mesatar)	1.8	2.4	2.0	1.6	1.9
Kursi i këmbimit, lek/usd (mesatar)	126.0	119.1	108.0	109.9	108.7
Kursi i këmbimit, lek/euro (mesatar)	136.1	134.2	127.6	123.0	123.8
Kursi nominal efektiv, NEER	110.2	105.2	96.8	92.0	89.9
Spektori Bankar					
Raporti i kredive me probleme/kredi total (%)	18.2	13.2	11.1	8.4	8.1


2.2 Ecuria e aktivitetit ekonomik

Aktiviteti ekonomik në vend shënoi rënie gjatë vitit 2020. Kjo rënie pasqyroj kontributin negativ të pothuajse të gjithë sektorëve të ekonomisë dhe komponentëve të kërkesës agregate. Rritja e stimulit fiskal kompensoi vetëm pjesërisht rënien e kërkesës së brendshme dhe të huaj. Me përfundimin e krizës shëndetësore, aktiviteti ekonomik pritet t'i rikthehet normave pozitive të rritjes gjatë vitit 2021 e në vijim. Aktiviteti ekonomik në vend, përgjatë vitit, ka vijuar kontraktimin e nisur në tremujorin e katërt të vitit 2019. Pas goditjes së marrë nga tërmeti i datës 26 nëntor 2019, ekonomia u përball me efektet negative të masave të ndërmarra për kontrollin e situatës epidemiologjike në vend. PBB-ja u tkurr me 5.5% gjatë nëntë muajve të parë të vitit 2020, pas rritjes me 2.9% shënuar në të njëjtën periudhë një vit më parë. Lehtësimi i masave kufizuese riaktivizoi ekonominë në tremujorin e tretë. Kjo ecuri pritet të ketë vijuar edhe gjatë tremujorit të katërt. Megjithatë, rikuperimi i ekonomisë në afatshkurtër mbetet i ngadaltë dhe nën nivelet e regjistruara në periudhën para pandemisë.

Tkurrja e aktivitetit ekonomik i atribuohet kryesisht zhvillimeve në sektorin e shërbimeve, i cili kontribuoi me -3.8 pikë përqindje në tkurrjen vjetore të PBB-së. Goditja negative ishte vecanërisht e fortë në degën e “Tregtisë, transportit, akomodimit dhe shërbimit ushqimor”, ku përfshihen aktivitetet më të prekura nga kufizimet e vendosura, me kontribut prej -2.5 pikë përqindjeje në tkurrjen e PBB-së. Edhe ndertimi, industria përpunuese dhe ajo nxjerrëse kontribuan në rënien ekonomike, ndonëse në një masë relativisht më të ulët (me 0.5 pikë përqindje secila). Ndërkohë, rritjet e vlerës së shtuar në bujqësi, pyje dhe peshkim, dhe energji dhanë një kontribut pozitiv për ecurinë ekonomike (përkatesisht, 0.4 pikë përqindje). Në reflektim të një ekonomie në tkurrje, komponenti i taksave neto shënoi gjithashtu rënie gjatë nëntë muajve të parë të vitit 2020, duke kontribuar me -1.0 pikë përqindje në ritmin vjetor të PBB-së.




Grafiku 1: Rritja e PBB për vitet 2011-2020



Grafiku 2: Struktura e PBB sipas sektorëve për vitin 2020


2.3 Inflacioni

Inflacioni mesatar për vitin 2020 rezultoi në nivelin 1.6%, duke qëndruar poshtë objektivit të BSH-së.



Grafiku 3: Ecuria e inflacionit dhe norma bazë e interesit (%)

Ne menyre grafike paraqitet Inflacioni sipas muajve per tre vitet e fundi.



Grafiku 4: Inflacioni sipas muajve për vitet 2018-2020

3. AKBN - AGJENCIA KOMBETARE E BURIMEVE NATYRORE

Bilanci energjistik është pjesë e informacionit të përgjithshëm të zhvillimit ekonomik të vendit në të cilin situata e COVID-19 pati një ndikim të ndjeshëm si pasojë e masave ekstreme të vendosura nga qeveria. Këto masa kufizuese ndikuan në menyrë direkte në sektorin e transportit i cili pati dhe rënien më të lartë të konsumit të energjisë.

Agjencia Kombëtare e Burimeve Natyrore në mbledhjen e të dhënave energjetike ka bashkëpunuar ngushtë me INSTAT-in, Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë (MIE), Entin Regullator të Energjisë (ERE), Drejtorinë e Përgjithshme të Doganave, Inspektoriatin Shtetëror Teknik dhe Industrial (ISHTI), Operatorin e Shpërndarjes së Energjisë Elektrike (OSHEE), Korporatën Energjetike Shqiptare (KESH), Operatorin e Sistemit të Transmetimit (OST) si dhe Kompanitë ARMO e Albpetrol.

Vlerësimi i të dhënave të bilancit është zhvilluar në konsultim me ekspertët e institucioneve të ndryshme të energjisë bazuar në të dhënat progresive në Sektorët e Energjisë Elektrike, Naftës dhe Gazit Natyror, Burimeve të Rinovueshme dhe Lëndëve të ngurta djegëse.

Analiza e Bilancit të Energjisë u krye duke përdorur modelin e EUROSTAT, një model bilanci i provuar dhe i përdorur më parë nga Agjencia Kombëtare e Burimeve Natyrore dhe që përdoret nga të gjitha vendet e Europës Juglindore. Rezultatet analitike ofruan matrica sasiore për vlerësimin e rezultateve të mundshme të Bilancit në shërbim të plotësimin të pyetësorëve analitik të energjisë.

Agjencia Kombëtare e Burimeve Natyrore (AKBN) i raporton Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë (MIE) për zhvillimin, mbikëqyrjen e përdorimit racional të burimeve natyrore sipas politikës së qeverisë dhe monitorimin e post-shfrytëzimit të minierave, naftës dhe energjisë.

Agjencia Kombëtare e Burimeve Natyrore ka një sërë përgjegjësish në fushën e energjisë të tilla si:

- propozimi, konsultimi dhe bashkëpunimi me strukturat përkatëse të qeverisë për hartimin e politikave dhe strategjive në fushën e minierave, hidrokarbureve dhe energjisë;
- zbatimi i politikave qeveritare në fushën e minierave, hidrokarbureve dhe energjisë;

- hartimi dhe publikimi i bilancit vjetor të energjisë, në nivel kombëtar dhe rajonal, në përputhje me formatet e Eurostat dhe Agjencisë Ndërkombëtare të Energjisë;
- propozimi i masave për rritjen e përdorimit të energjisë në ciklin e energjisë;

Agjencia Kombëtare e Burimeve Natyrore prej vitit 2011 ndërton Bilancin Kombëtar të Energjisë në bashkëpunim me:

- EUROSTAT (Institucioni i Statistikave të Bashkimit Europian), European Commission – Eurostat, Unit E.5: Energy, 2920 Luxembourg.
- IEA (Agjencinë Ndërkombëtare të Energjisë), (31-35, rue de la Fédération, 75739, Paris, Cedex 15, France).
- UNSD, (Institucionin e Statistikave të Kombeve të Bashkuar), United Nations Statistics Division, Energy Statistics Section 2 UN plaza, DC2-1414, New York, NY 10017, USA.

AKBN bashkëpunon me INSTAT duke i përgatitur të gjitha të dhënat në fushën e energjisë dhe të dy institucionet së bashku këtë informacion e raportojnë në EUROSTAT duke ndjekur procedurat e EDAMIS (Sistemi Elektronik i Administrimit të të Dhënave dhe Menaxhimit të Informacionit <https://webgate.ec.europa.eu/edamis/>).

AKBN është pjesë e grupit të punës në “ENERGY COMMUNITY” (Komunitetin e Energjisë në Vjene) për raportimin e statistikave të energjisë për Shqipërinë duke marrë pjesë regullisht në takimet që organizon ky institucion për statistikat e vendeve të Europës Juglindore dhe të ish vendeve të Bashkimit Sovjetik.

AKBN-ja që prej vitit 2015 është pjesë e organizatës JODI (Iniciativa e Përbashkët e Organizimit të të Dhënave www.jodidata.org) institucion që bashkëpunon ngushtë me 6 organizata (APEC, Eurostat, IEA, OLADE, OPEC and UNSD) ku ne dërgojmë regullisht të dhënat mujore të prodhimit të naftës, gazit dhe të bilancit të rafinerive të Shqipërisë.

AKBN-ja, në bashkëpunim me EUROSTAT dhe IEA-në ndërton bilancin kombëtar të energjisë duke përmbledhur të dhënat në 5 pyetësorë (të naftës, gazit, qymyrit, energjisë elektrike dhe burimeve të rinovueshme). Përgatitja e këtyre pyetësoreve ka për qëllim të thjeshtësojë paraqitjen e të dhënave si dhe për të minimizuar riskun e të dhënave të gabuara.

AKBN-ja hedh të dhënat në programin SHARES (SHort Assessment of Renewable Energy Sources) i cili ka si qëllim të thjeshtësojë llogaritjen kontributit të Burimeve të Rinovueshme bazuar në direktivën 2009/28/EC. Kjo metodikë është e unifikuar për të gjitha vendet e BE-së dhe të Europës Jug-Lindore. Zbatimi i saj parandalon çdo parregullsi të parametrave dhe rregulla të ndryshme të përdorura në metoda të ndryshme llogaritëse si dhe siguron rezultate të harmonizuara dhe të krahasueshme për të gjitha vendet raportuese. Për këtë arsye, metoda SHARES konsiderohet të jetë një qasje me efikase në vlerësimet/llogaritjet individuale të kryera nga çdo shtet anëtar i BE.

4. BILANCI ENERGJETIK

Bilancit energjetik për vitin 2020 prezanton problemet dhe sfidat e mprehta energjetike me të cilat ballafaqohet vendi ynë. Tremujori i parë dhe i dytë pati një rënie të konsumit të energjisë si pasojë e pandemicsë dhe të masave të qeverisë në kufizimin e lëvizjeve të cilat patën ndikim direkt në uljen e konsumit të sektorit të transportit në masën 27%, si dhe sektorit të shërbimeve në masën 12%. Ende në informacinet që ndihmojnë në përgatitjen e bilancit energjetik ka probleme në sigurimin e të dhënave, sidomos nga sektori privat të cilat sigurohen me mjaft vështirësi. Këto problematika duhet të gjejnë zgjidhje nëpërmjet përmirësimit të kuadrit ligjor, i cili duhet të detyrojë institucionet publike dhe private të raportojnë bilancet energjetike duke përfshirë këtu dhe aktivitetet industriale. Në bashkitë e vendit tonë vazhdon akoma të ketë probleme në ndërtimin e një data-baze për grumbullimin e të gjithë informacionit në territorin ku ato ushtrojnë aktivitetin.

Agjencia Kombëtare e Burimeve Natyrore në mbledhjen e të dhënave energjetike ka bashkëpunuar ngushtë me INSTAT-in, Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë (MIE), Entin Regullator të Energjisë (ERE), Drejtorinë e Përgjithshme të Doganave, Inspektoriatin Shtetëror Teknik dhe Industrial (ISHTI), Operatorin e Shpërndarjes së Energjisë Elektrike (OSHEE), Korporatën Energjetike Shqiptare (KESH), Operatorin e Sistemit të Transmetimit (OST) si dhe Kompaninë ARMO.


5. PRODUKTET PRIMARE

Furnizimi me energji primare në Shqipëri dominohet nga nafta, prodhimi i energjisë elektrike nga hidrocentralet si dhe biomasa, të cilat janë të pa mjaftueshme për realizimin e kërkesës totale për energji. Diferencat plotësohet nëpërmjet importit, vecanërisht për nënproduktet e naftës, energjisë elektrike dhe qymyrit.

5.1 Nafta dhe Gazi


Prodhimi në vend i naftës për vitin 2020 ka patur një prodhim 758.1668 Toe me një rritje krahasuar me vitin 2019 prej -246.92 Ktoe ose 24.57 % kjo si pasojë e rritjes së tregjeve të shitjes. Në vitin 2020 nafta brut nga marrëveshjet hidrokarbure ishte **680.773 Ktoe**, ku shitjet brenda vendit kanë qenë **119.766 Ktoe** dhe eksportet 577.3215 Ktoe .

Albperoli për vitin 2020 ka patur një prodhim të naftës bruto 40.92 Ktoe nga këto 17.6 ktoe janë prodhuar nga vendburimet ranore dhe 23.76 ktoe nga vendburimet gëlqerore. Shtjet e naftës brut në tregun vendas për vitin 2019 për Albperolin ishin 14.5 Ktoe.




Grafiku 5: Ecuria e Prodhimit, Importit dhe Eksportit të produkteve të naftës (ktoe)

Për vitin 2020 sasia e naftës brut për rafinim ka qenë 134.37 ktoe duke patur një ulje krahasuar me vitin 2019 ku sasia e rafinimit ka qenë 335.27 ktoe. Kjo ulje e sasise se rafinimit ka ardhur si rezultat i problemeve të përpunimit të naftës brut.



Grafiku 6: Ecuria e përpunimit të naftës brut, (ktoe) 2009-2020


Importi i produkteve të naftës dhe i naftës bruto për vitin 2020 arrin vlerën 1113.55 ktoe me një ulje 161.30 ktoe krahasuar me vitin 2019. Gazoili, benzina dhe gaz i lëngshëm i naftës vazhdojnë të dominojnë në importin e produkteve të naftës.



Grafiku 7: Ecuria e Import eksport të produkteve të naftës, 2009-2020 (ktoe)

Eksporti i naftës dhe i nënprodukteve të saj për vitin 2020 për naftën brut ishte 577.32 ktoe dhe i nënprodukteve të naftës 103.44 ktoe me një ulje 80 ktoe si pasojë e kërkesës nga tregu i importit.

Prodhimi i gazit në vendin tonë për vitin 2020 ka qenë në total gaz shoqërues i naftës, rreth 57.241.milion Nm³, sasi gati e papërfillshme dhe që shërben vetëm për proceset teknologjike të industrisë së naftës. Pavarësisht nga angazhimet e strukturave të shtetit dhe nxitjes së investitorëve të huaj, vendi ynë nuk është lidhur me rrjetin ndërkombëtar të gazit. Është e kuptueshme së lidhja e Shqipërisë me rrjetin e gazit do të ketë një ndikim pozitiv në përmirësimin e situatës energjetike në vend, duke ndikuar në mënyrë të ndjeshme në raportet e përdorimit të energjive ku deri më sot ngarkesa kryesore i takon nënprodukteve të naftës dhe energjisë elektrike.



Grafiku 8: Prodhimi Gazit 2009-2020 (ktoe)

- **Projekti TAP (Trans Adriatic Pipeline)**

Projekti TAP ka për qëllim të lehtësojë transportin e gazit natyror të prodhuar në fushat e gazit në territorin e Republikës së Azerbajxhanit dhe për të furnizuar sipas Marrëveshjeve përkatëse të Shitjes së Gazit Shah Deniz (SD), por kryesisht të lehtësojë zhvillimin e fazës së II të fushës së Gazit Shah Deniz (SD).

Në 15 Nëntor 2020, Projekti TAP përfundoi. Ndërtimi i tubacionit tokësor përmes Greqisë,

Shqipërisë dhe Italisë ka përfunduar në përputhje me të gjitha kriteret dhe standartet e një projekti gjigand. Kufizimet e COVID -19 ishin tek të gjitha vendet pritëse të TAP në vitin 2020, megjithatë, TAP vendosi një numër lehtësimesh të cilat ishin të suksesshme në parandalimin e vonesave të dukshme dhe kjo bëri që:


- Në Greqi të gjitha punimet kryesore të ndërtimit përfunduan. Dorëzimi nga projekti në operim/funksionim është përfunduar dhe mbushjet me gaz janë paraqitur tek të pesta (5) pjesët e tubacionit.
- Në Shqipëri, të përfundojë ndërtimi dhe mbushja me gaz e të gjitha seksioneve dhe provat e sigurisë janë paraqitur të gjitha pjesët e tubacionit.
- Në Itali, punimet e ndërtimit kanë përfunduar dhe është prezent gazi të gjitha pjesët e tubacionit. Pavarësisht kufizimeve për shkak të COVID – 19, në Itali, ku punimet kanë patur një ngadalësi, janë arritur një numër pikash kyçe gjatë vitit 2020 përfshirë përfundimin e tubacionit detar (në mënyrë të suksesshme mbi 98.4 km sipas planifikimit) dhe përfundimin e mikro-tunelit në Blloqet 2 tek pjesa tokësore e gazsjellësit. Pronat/Asetet tek të gjitha vendet pritëse(Greqi,Shqipëri,Itali) janë dorëzuar për operim dhe tani janë në kontroll nga kompania TAP AG sipas marrëveshjeve të nënshkruara.

Duke patur parasysh të gjitha arritjet teknike, në datën 15 Nëntor 2020 TAP realizoi Datën Komerciale të Operimit (COD) ashtu si dhe ishte parashikuar tek Vendimi i Përgjashtimit të Komisionit European dhe Paragrafi 4.10.2 i Opinionit Përfundimtar të Përbashkët i Autoriteteve Rregullatore në vend mbi përjashtimin e TAP nga kërkesat e aksesit të palëve të treta, rregullimit të tarifave dhe veçimit të pronësisë përcaktuar në Nenet 9, 32, 41(6), 41(8) dhe 41(10) të Direktivës 2009/73/EC.

Momenti i Datës Komerciale të Vendosjes në Funksion (COD) në datën 15 Nëntor, përbën fillimin e periudhës 25 vjeçare të përjashtimit nga aksesit i palëve të treta, rregullimi i tarifave dhe veçimi i pronësisë. Që nga kjo datë dhe në vazhdim, Transportuesit e TAP duhet të paguajnë tarifa, si përcaktohet sipas Kodit të Tarifave të TAP dhe publikuar tek faqja zyrtare e TAP.

5.2 Qymyri

Për vitin 2020 prodhimi i zhavorit bituminoz ka qenë 42.06 ktoe si dhe importi i qymyrit ka qenë 92.08 ktoe. Të dyja këto lëndë karahasur me vitin 2019 kanë pësuar një ritje si pasojë e përdorimit nga industria e çimentos të koksit të naftes i cili ka një fuqi kalorifike të lartë si dhe çmim të ulët në tregun ndërkombëtar.



Grafiku 9: Ecuria e prodhimit dhe importit të Qymyrit 2009-2020 (kton)

5.3 Prodhimi i Energjisë Elektrike

Përsa i takon prodhimit të Energjisë Elektrike, duke marrë në konsideratë dhe analizën e historikut të prodhimit të energjisë elektrike të regjistruar në vend, rezulton se gjatë Vitit 2020 janë 5,313 GWh. Sasia e prodhuar rezulton të jetë nën mesataren e prodhimit të energjisë elektrike në periudhën 2009 – 2020, e cila është në vlerat 5,882 GWh. Prodhimi i realizuar për Vitin 2020 rezulton rreth 10 % më i ulët se mesatarja e prodhimit për periudhën 2009 – 2020. Kjo për faktin se, prurjet e ujit në basenet e impianteve kryesor të prodhimit të energjisë elektrike kanë qenë në tërësinë e tyre nën mesataren shumë vjeçare. Është vërejtur se gjithashtu se prurjet mesatare të ujit në basenin kryesor të administruar nga ana e KESH sh.a., në basenin e Hidrocentralit të Fierzës janë përgjithësisht nën mesataren historike dhe vetëm në muajin Tetor rezultojnë me rreth 23 m³/sek më të larta se mesatarja shumëvjeçare, duke krahasuar prej vitit 1991.

Në këtë kuadër Viti 2020 konsiderohet si një vit jo i mirë hidrologjik edhe për faktin se pavarësisht rritjes së kapaciteteve prodhuese përgjatë Vitit 2020, prodhimi total i energjisë elektrike për këtë vit ka rezultuar në sasinë **5,313 GWh**, ose rreth 569 GWh më pak se prodhimi mesatar i energjisë elektrike në periudhën 2009 – 2020.

Gjithashtu, krahasuar me sasinë e energjisë elektrike prej 8,552 GWh të prodhuar gjatë vitit 2018, i cili konsiderohet viti me prodhimin më të lartë të energjisë elektrike në vendin tonë, prodhimi i KESH sh.a. për vitin 2020 rezulton të jetë 3,090 GWh ose rreth 38% më i ulët.

Ky vit, jo i mirë hidrologjik, shkaktoi realizimin e një importi të konsiderueshëm të energjisë elektrike për mbulimin e kërkesës dhe furnizimin e pa ndërprerë të klientëve në vend. Balanca neto e shkëmbimit të energjisë elektrike për Vitin 2020 ishte import neto në sasinë prej 2,275 GWh, e cila është rreth 31% të vlerës totale të konsumit, duke rezultuar si një ndër vitet me import të madh të energjisë elektrike gjatë dhjetëvjeçarit të fundit.

Balanca e shkëmbimit të energjisë elektrike (importi) për Vitin 2020 në total është 3,238 GWh, në dhënie rezulton në sasinë 963 GWh dhe në marrje 2,276 GWh. Prodhimi i energjisë elektrike në **5,313 GWh** u realizua nga centralet në zotërim të kompanisë publike të gjenerimit KESH sh.a., në sasinë prej **3,090 GWh** ose gati 58 % të të gjithë prodhimit të energjisë elektrike në rang vendi. Pjesa tjetër e prodhimit prej **2,222 GWh** u prodhua nga centralet e tjera, e cila zë rreth 42%, të të gjithë prodhimit të energjisë elektrike.

Sikurse vërehet dhe nga këto shifra, pjesa e prodhimit, që realizohet nga prodhuesit e pavarur private të energjisë elektrike, zë një pjesë të konsiderueshme në prodhimin vendas. Numri i prodhuesve të pavarur të energjisë elektrike vjen duke u rritur nga viti në vit, duke rritur peshën e këtyre prodhuesve në treg, i cili është një hap i rëndësishëm për liberalizimin e tregut të energjisë elektrike në vendin tonë. Përsa i takon shtimit të kapaciteteve gjeneruese dhe me ngritjen e Bursës së Energjisë Elektrike nëpërmjet kontratave për diferencë, do të optimizohet edhe efekti financiar i tyre për klientët e energjise elektrike.

Përgjatë Vitit 2020 kanë hyrë në prodhim gjithsej 20 centrale prodhuese të energjisë elektrike, me një fuqi të instaluar prej 227.8 MW, të cilët kanë prodhuar gjatë Vitit 2020 sasinë prej 182,816 MWh.

Prodhimi i energjisë elektrike i realizuar nga impiantet që kanë hyrë në prodhim gjatë Vitit 2020 zë rreth 3.44 % të prodhimit total vendas të energjisë elektrike, që është një vlerë e cila ka arritur

të mbulojë dhe tejkalojë ecurinë e parashikuar të rritjes së kërkesës së energjisë elektrike në vitet në vijim. Kapaciteti i instaluar i centraleve të lidhura në rrjetin e transmetimit gjatë Vitit 2020 është rreth 2,200 MW dhe prodhimi neto i tyre ka rezultuar të jetë 4,712,074 MWh. Kapaciteti i instaluar i centraleve të lidhura në rrjetin e shpërndarjes përgjatë Vitit 2020 është rreth 306 MW dhe prodhimi neto i tyre ka rezultuar të jetë 601,090 MWh. Për vitin 2020, numri total i centraleve prodhuese private të cilat kanë prodhuar energji elektrike është 216, ku 8 prej tyre janë prodhues privat të pavarur të cilët zotërohen nga 3 subjekte të liçensuara, kurse pjesa tjetër prej 208 centrale janë prodhues me përparësi të energjisë elektrike, të cilët zotërohen nga 155 subjekte në aktivitetin e prodhimit të energjisë elektrike. Në total, kapaciteti i instaluar i centraleve prodhuese private është 1,058 MW, ku kapaciteti i instaluar i centraleve të prodhuesve të pavarur është 436 MW, ndërsa 622 MW i përket centraleve të prodhuesve më përparësi të energjisë elektrike.

Kërkesa për energji elektrike në vitin 2020 arriti në vlerën prej 7,589 GWh. Krahasuar me Vitin 2019 vërehet një ulje e lehtë e konsumit të energjisë elektrike në vend me 23 GWh krahasuar me kërkesën e cila për vitin 2019 ishte në vlerat prej 7,612 GWh. Ulja e kërkesës e vërejtuar përgjatë këtij viti, e cila duhet thënë se është vënë re dhe më parë, ka të bëjë kryesisht me ndryshimet klimatike, efikasitetin energjetike apo dhe vazhdimin e zbatimit të masave për uljen e vjedhjes së energjisë elektrike dhe kryesisht me masat e ndërmarra nga ana e Qeverisë Shqiptare për kufizimet që lidhen me përhapjen e pandemisë duke filluar nga Marsi i vitit 2020. Këto masa ndër të tjera kanë ndikuar dhe në uljen e kërkesës për energji elektrike pasi një pjesë e bizneseve kanë qenë të detyruara të punojnë me orare të reduktuara ose të mbyllen krejtësisht.

Në këtë kontekst, humbjet e energjisë elektrike në sistemin e shpërndarjes për Vitin 2020 sipas të dhënave të raportuara nga ana e kompanisë, arrijnë në vlerat 21.48%, duke shënuar një ulje të lehtë të nivelit të humbjeve krahasuar me vlerën prej 21.79% të vitit 2019. Niveli i humbjeve të energjisë elektrike vijon të ketë një rënie nga viti në vit, duke tentuar të arrijë në nivelet e përcaktuara me VKM-në Nr. 253, datë 24.04.2019.

5.3.1 Prodhimi

Prodhimi i Energjisë Elektrike në vendin tonë realizohet nga subjektet e liçensuara në ERE për aktivitetin e prodhimit të energjisë elektrike si dhe veteprodhues, bazuar në Ligjin Nr. 43/2015 “Për Sektorin e Energjisë Elektrike”, i ndryshuar. Aktualisht prodhimi i energjisë elektrike përbëhet nga dy komponent kryesor. Prodhimi që realizohet nga Shoqëria publike KESH sh.a.

dhe prodhimi që realizohet nga subjektet e tjera që zhvillojnë aktivitetin e prodhimit të energjisë elektrike. KESH sh.a, është shoqëria më e madhe prodhuese e energjisë elektrike në Shqipëri, me capital tërësisht shtetëror. KESH sh.a. është e ngarkuar me detyrimin e shërbimit publik për furnizimin me Energji Elektrike të Furnizuesit Universal sh.a. dhe mbulimin e humbjeve të Energjisë Elektrike në rrjetin e Shpërndarjes, sipas përcaktimeve të VKM Nr. 244 datë 30.03.2016, e ndryshuar.

Shoqëritë e tjera prodhuese të energjisë elektrike janë subjekte private, të tilla si: prodhuesit me përparësi dhe ato të pavarur të energjisë elektrike, si dhe HEC Lanabregas dhe veteprodhuesit. Këto subjekte të licencuara në vite nga ERE shfrytëzojnë centralet ekzistuese apo të reja, kryesisht nëpërmjet marrëveshjeve të koncesionit apo kontratave për shfrytëzimin dhe administrimin e impianteve prodhuese të Energjisë Elektrike. Këto kontrata janë të nënshkruara me Qeverinë Shqiptare si dhe Autoritete të tjera përgjegjëse të përcaktuara me ligj, po ashtu dhe disa prej centraleve prodhuese që operohen në kuadër të marrëveshjeve të privatizimit. Kapaciteti total prodhues i energjisë elektrike i instaluar në vendin tonë deri në 31 Dhjetor 2020 është **2,506 MW**. Ky kapacitet ka pasur një nivel rritje në vitin 2020 prej 231 MW, krahasuar me vitin 2019.

Kapaciteti total prodhues i energjise elektrike i kompanisë publike KESH sh.a. është 1448 MW dhe përbën rreth 58 % të fuqisë totale të instaluar në vendin tonë.

Kapaciteti total i instaluar i prodhuesve të tjerë të energjisë elektrike është 1 058 MW dhe përbën rreth 42 % të fuqisë totale të instaluar në vendin tonë.

Prodhimi neto vendas i energjisë elektrike i realizuar për vitin 2020 është **5,313,033 MWh**. **3,090,199 MWh** u prodhuan nga centralet në zotërim të kompanisë publike KESH sh.a. **2,222,834 MWh** u prodhuan nga centralet e tjera. Prodhimi i energjisë elektrike i realizuar nga KESH sh.a. zë 58 % të gjithë prodhimit të energjisë elektrike në vendin tonë dhe prodhimi i energjisë elektrike nga prodhuesit e tjerë zë rreth 42 %. Centralet e prodhimit të energjisë elektrike janë të lidhura si në rrjetin e transmetimit të energjisë elektrike ashtu dhe në rrjetin e shpërndarjes. Kapaciteti i instaluar i centraleve të lidhura në rrjetin e transmetimit gjatë vitit 2020 është rreth 2,190 MW dhe prodhimi neto i tyre ka rezultuar të jetë 4,712,074 MWh. Kapaciteti i instaluar i centraleve të lidhura në rrjetin e shpërndarjes përgjatë vitit 2020 është rreth 306 MW dhe prodhimi neto i tyre ka rezultuar të jetë 600,958 MWh.

Tabela 2. Të dhëna mbi prodhuesit për vitin 2020


Te dhena mbi prodhuesit 2020		Rrjeti	Numri Subjektev e	Numri Implantev e	Kapaciteti instaluar (MW)	Prodhimi 2020 (MWh)
P.Pub	Prodhues publik (Ngarkuar me detyrimin e shërbimit publik)	Lidhur ne OST	1	4	1,448	3,090,199
P.Pav	Prodhues te pavarur (Prodhues ne treg te hapur)	Lidhur ne OST	3	8	436	855,441
PPE	Prodhues me perparesi (Perfitojne nga skemat mbeshetese)+Ashta	Lidhur ne OST	29	44	306	766,434
	Prodhues me perparesi (Perfitojne nga skemat mbeshetese)	Lidhur ne OSSH	115	153	285	568,693
	Prodhues me perparesi Fotovoltaike (Perfitojne nga skemat mbeshetese)	Lidhur ne OSSH	11	11	21	32,265
			159	220	2,496	5,313,032

Në figurën më poshtë paraqitet prodhimi neto vendas për Vitin 2020, duke evidentuar kontributin në prodhimin e energjise elektrike të KESH sh.a., si prodhuesi i vetëm publik si dhe kontributet e prodhuesve të tjerë Privat/me Koncesion. Prodhimi i realizuar nga kompania publike KESH sh.a., vazhdon të ketë peshën kryesore në prodhimin vendas dhe për Vitin 2020.

Tabela 3: Prodhimi neto vendas i energjisë elektrike për vitin 2020

Prodhimi neto vendas per vitin 2020 (MWh)	2020
HEC-et/PPE (Private/Koncesion) ne rrjetin e OSSH sh.a	540,050
HEC-et/PPE (Private/Koncesion) ne rrjetin e OST sh.a	579,212
HEC-et e pavarur IPP ne rrjetin e OST sh.a	855,441
HEC Lanabregas	28,643
HEC Ashta	187,223
Centrale Fotovoltaike	32,265
Prodhimi nga HEC-et e KESH sh.a	3,090,199
Prodhimi total vendas	5,313,033


Nga analiza e historikut të prodhimit të energjisë elektrike të regjistruar në vend, rezulton se viti 2020 me sasinë e prodhuar prej 5,313 GWh, vazhdon të jetë nën mesataren e prodhimit të energjisë elektrike në periudhën 2009 – 2020. Mesatarja e prodhimit të energjisë elektrike për periudhën 2009 – 2020 është 5,882 GWh. Prodhimi i realizuar për Vitin 2020 rezulton rreth 9.7 % më i ulët se mesatarja e prodhimit për periudhën 2009 – 2020.



Grafiku 9: Prodhimi i energjisë elektrike në raport me mesataren 2009-2020

Prodhimi maksimal mujor i energjisë elektrike për Vitin 2020, është shënuar në muajin Tetor me sasinë **551,275 MWh**. Ky prodhim është realizuar nga hidrocentralet në administrim të KESH sh.a. në masën deri **61 %**, ndërkohë që prodhimi minimal mujor i energjisë elektrike gjatë Vitit 2020 rezulton në muajin Shtator në sasinë **334,730 MWh**.

Në grafik vihet re se Viti 2020 konsiderohet si një vit jo i mirë hidrologjik, kjo për faktin se pavarësisht rritjes së kapaciteteve prodhuese përgjatë Vitit 2020, prodhimi i energjisë elektrike për këtë vit ka rezultuar në sasinë **5,313 GWh**, pra 569 GWh më pak se prodhimi mesatar i energjisë elektrike në periudhën 2009 – 2020. Duke marrë në konsideratë faktin se vendi ynë e bazon prodhimin e energjisë elektrike kryesisht në burimet hidrike, në vitet jo të mira hidrologjike ku futet edhe Viti 2020, prodhimi i energjisë elektrike është më i ulët se mesatarja shumë vjeçare në periudhën 2009 – 2020.



Grafiku 10: Prodhimi vendas dhe balancet eksport-import 2009-2020

5.3.2 Kapacitetet dhe Prodhimi i Energjisë Elektrike

Prodhimi neto vendas i energjisë elektrike i realizuar për vitin 2020 është **5,313,033 MWh**. **3,090,199 MWh** u prodhuan nga centralet në zotërim të kompanisë publike KESH sh.a. **2,222,834 MWh** u prodhuan nga centralet e tjera. Prodhimi i energjisë elektrike i realizuar nga KESH sh.a. zë 58 % të gjithë prodhimit të energjisë elektrike në vendin tonë dhe prodhimi i energjisë elektrike nga prodhuesit e tjerë zë rreth 42 %. Centralet e prodhimit të energjisë elektrike janë të lidhura si në rrjetin e transmetimit të energjisë elektrike ashtu dhe në rrjetin e shpërndarjes. Kapaciteti i instaluar i centraleve të lidhura në rrjetin e transmetimit gjatë vitit 2020 është rreth 2,190 MW dhe prodhimi neto i tyre ka rezultuar të jetë 4,712,074 MWh. Kapaciteti i instaluar i centraleve të lidhura në rrjetin e shpërndarjes përgjatë vitit 2020 është rreth 306 MW dhe prodhimi neto i tyre ka rezultuar të jetë 600,958 MWh.

5.3.3 Gjendja e TEC-it Vlorë.

Shoqëria KESH sh.a. është aksionere e vetme e shoqërisë Termocentrali Vlorë sh.a. (TEC Vlora sh.a.), shoqëri kjo e cila ka në administrim asetin gjenerues TEC Vlora. Përgjatë vitit 2020, shoqëria TEC Vlora sh.a., ka ushtruar veprimtarinë e saj në lidhje me konservimin e asetit

gjenerues i cili nuk është në gjendje pune për shkak të defektit të shfaqur në sistemin e ftohjes që nga viti 2012. Ndërkohë, nga Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë, më datë 28.12.2019, u bë shpallje publike për oferta për konçesionin me objekt “Për rehabilitimin dhe vënien në punë të Termocentralit të Vlorës si dhe të ndërtimit të tubacionit Fier-Vlorë të furnizimit me gaz të TEC-it, të formës R.O.O.T.”. Proçedura kishte si autoritet kontraktor Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë, e cila organizoi edhe garën për kalimin në konçesion të këtij aseti gjenerues, e cila sikurse edhe publikuar është anuluar si procedurë.

Meqë TEC Vlora sh.a. ndodhet në kushte konservimi, konsumi vetjak i TEC Vlorës garantohej nëpërmjet linjës së furnizimit 220 kV, N/Stacioni Babicë dhe mbulohet nga KESH sh.a.

5.3.4 Prodhimi nga HEC-et Private/Koncesion të Energjisë Elektrike

Prodhimi i energjisë elektrike i realizuar nga centralet prodhuese private për vitin 2020 është 2,979,252 MWh ose rreth 42 % e prodhimit total vendas. Për vitin 2020, numri i centraleve prodhuese private të cilat kanë prodhuar energji elektrike është 216, ku 8 prej tyre janë prodhues të pavarur të cilët zotërohen nga 3 subjekte të liçensuara, kurse pjesa tjetër prej 208 centrale janë prodhues me përparësi të energjisë elektrike të cilët zotërohen nga 155 subjekte në aktivitetin e prodhimit të energjisë elektrike. Në total, kapaciteti i instaluar i centraleve prodhuese private është 1,058 MW, ku kapaciteti i instaluar i centraleve të prodhuesve të pavarur është 436 MW, kurse 622 MW i përket centraleve të prodhuesve me përparësi të energjisë elektrike. Të dhënat mbi grupimet e prodhuesve, janë paraqitur në mënyrë të përmblëdhur më poshtë.

Tabela 4. Të dhëna mbi prodhuesit e pavarur për vitin 2020

Te dhëna mbi Prodhuesit e Pavarur dhe ato me Përparësi 2020		Rrjeti	Nr. i Subjekteve	Nr. i Implantëve	Kapaciteti instaluar (MWh)	Prodhimi 2020 (MWh)
P.Pav	Prodhues të Pavarur (Prodhues në treg të Hapur)	Lidhur në OST	3	8	436	855,441
	Prodhues me Përparësi (Përfitojnë nga skemat mbështetëse)+Ashta	Lidhur në OST	29	44	306	766,434
PPE	Prodhues me Përparësi (Përfitojnë nga skemat mbështetëse)	Lidhur në OSSH	115	153	285	568,825
	Prodhues me Përparësi Fotovoltaike (Përfitojnë nga Skemat Mbështetëse)	Lidhur në OSSH	11	11	21	32,265
			158	216	1,048	2,222,965

Tabela 5. Të dhëna mbi prodhuesit me përparësi për vitin 2020.

TE DHENA MBI PRODHUESIT E PAVARUR 2020					
	HEC-et	MW	SUBJEKTI	Lidhja	Prodh. 2020
P.Pav	HEC "ULEZ"	25,200	"Kurum International" sh.a.	110 kV	303,063
P.Pav	HEC "SHKOPET"	24,000		110 kV	
P.Pav	HEC "BISTRICA 1"	22,500		110 kV	
P.Pav	HEC "BISTRICA 2"	5,000		110 kV	
P.Pav	HEC "PESHQESH"	27,940	"Ayen AS Energi" sh.a.	220 kV	78,962
P.Pav	HEC "FANGU"	74,600		220 kV	177,918
P.Pav	HEC "BANJE"	73,000	"Devoll Hydropower" sh.a	110 kV	135,775
P.Pav	HEC "MOGLICE"	184,000		110 kV	159,722
		436,240			855,441

Tabela 6. Të dhëna mbi prodhuesit e pavarur dhe me përparësi për vitin 2020

Te dhena mbi Prodhuesit e Pavarur dhe ato me Perparesi 2020		Rrjeti	Nr. i Subjekteve	Nr. i Impianteve	Kapaciteti instaluar (MW)	Prodhimi 2020 (MWh)
PPE	Prodhues me Perparesi (Perfitojne nga skemat mbeshtetese)+Ashta	Lidhur ne OST	29	44	306	766,434
	Prodhues me Perparesi (Perfitojne nga skemat mbeshtetese)	Lidhur ne OSSH	115	153	285	568,825
	Prodhues me Perparesi Fotovoltaike (Perfitojne nga Skemat Mbeshtetese)	Lidhur ne OSSH	11	11	21	32,265
			155	208	612	1,367,524

5.3.5 Prodhimi nga impiantet fotovoltaike


Gjatë vitit 2020 kanë hyrë në prodhim subjektet e mëposhtme, të cilat realizojnë prodhim të energjisë elektrike nga centrale fotovoltaike.

Tabela 7. Prodhimi i energjisë elektrike nga centralet Fotovoltaike

PRODHIMI NGA CENT FOTOVOLTAIKE TE LIDHURA ME RRJETIN E SHPERNDARJES (MWh) 2020					
	CENTRAL FOTOVOLTAIK	MW	SUBJEKTI	LIDHJA	PROG. 2020
PPE	UKKO (pa sistemuar ne sistem)	1	"UKKO sh.a (Ujsjell. Kanal. Korce)	35 kV	
PPE	SEMAN-2	2	"SEMAN N2SUN" sh.p.k	35 kV	4,119
PPE	TOPOJE	2	"SONNE" sh.p.k	35 kV	4,095
PPE	TOPOJE 2	2	"AED SOLAR" sh.p.k	35 kV	4,088
PPE	TOPOJE (SHEQ MARINAS)	2	"AGE SUNPOWER" sh.p.k	35 kV	4,100
PPE	TOPOJE (SHEQ MARINAS) 2	2	"SEMAN SUNPOWER" sh.p.k	35 kV	4,124
PPE	SEMAN SOLAR	2	"SEMAN1 SOLAR" sh.p.k	35 kV	4,079
PPE	ES 2019 sh.p.k	2	"ES 2019" sh.p.k	35 kV	244
PPE	SMART WATT sh.p.k	2	"SMART WATT" sh.p.k	35 kV	243
PPE	TREN BILISHT	2	"RTS" sh.p.k	35 kV	3,228
PPE	PLUG LUSHNJE	2	"AEE" sh.p.k	10 kV	3,946
	TOTAL MUJOR				32,265

5.4 Konsumi i energjisë elektrike

Konsumi total vjetor i Energjisë Elektrike (duke përfshirë edhe konsumin e klientëve në treg të parregulluar) në Shqipëri për periudhën 2003 deri në 2020 paraqitet në mënyrë grafike si më poshtë:




Grafiku 11: Konsumi i përgjithshëm i energjisë elektrike ndër vite.


Siç vërehet në paraqitjen grafike, konsumi më i ulët i energjisë elektrike i regjistruar në vendin tone është në vitin 2007 me 5,767,652 MWh dhe konsumi më i lartë i energjisë elektrike është ai i regjistruar në vitin 2013 me 7,855,698 MWh. Për vitin 2020 konsumi i energjisë elektrike në vendin tonë është 7,588,637 MWh. Krahasuar me vitin 2019 vërehet një ulje e lehtë e konsumit të energjisë elektrike në vend me 23,442 MWh.

5.4.1 Struktura e Konsumit të Energjisë Elektrike

Në figurën e mëposhtme paraqiten peshat specifike në faturim që zënë kategoritë e klientëve tariforë.




Grafiku 12: Shpërndarja e numrit të klientëve 2020 sipas kategorive (%).



Grafiku 13: Raportet e faturimit sipas kategorive të klientëve 2020.(%)

Të dhënat e paraqitura më sipër tregojnë se numri i përgjithshëm i klientëve për vitin 2020 është 1 273 000. Dhe për vitin 2020 pjesën më të madhe të klientëve të OSSH sh.a. e zenë klientët familjar që shkojnë në 86.17 % të numrit total të klientëve të OSSH sh.a. Në shpërndarjen demografike të klientëve të OSSH sh.a. dhe për vitin 2020 pjesa më e madhe është në Tiranë në rreth 26.5 % e gjithë klientëve që ka OSSH sh.a. Struktura e klientëve të OSSH sh.a. reflektohet dhe në strukturën e faturimit të energjisë elektrike të realizuar për vitin 2020. Klientet familjar zenë pjesën më të madhe në OSSH sh.a. dhe pjesën më të madhe të energjisë së faturuar për vitin 2020 respektivisht 51.8 % të gjithë faturimit të realizuar për vitin 2020.




Grafiku 14: Klientet Familjarë kundrejt konsumit total të vendit në vite.

Klientët familjare zënë rreth 38.96 % të konsumit total, shifër më e lartë kjo krahasuar me konsumin për të njëjtën kategori për vitin 2019 i cili ishte në masën 36.1 %.

5.4 Import – Eksport

Në grafikun e Figurës më poshtë është paraqitur balanca (hyrje – dalje) import-eksport e energjisë elektrike për periudhën 2009 – 2020. Për 10-vjeçarin e fundit, me përjashtim të vitit 2010, 2016 (vlera të vogla) dhe në 2020 vendi ynë rezulton të jetë një importues neto i energjisë elektrike. Sqarojmë se vlerat e paraqitura përfaqësojnë të gjitha flukset hyrëse e dalëse nga të gjithë pjesëmarrësit e tregut të energjisë elektrike në Shqipëri.




Grafiku 15: Balanca Import - Eksport e energjisë elektrike në vite.

5.6 Humbjet e energjisë elektrike

Gjatë vitit 2020 efektiviteti i shitjes të energjisë elektrike vazhdon në vlera të rritura në reference gjithnjë të faktorëve përcaktues në nivelin e efijencës së konsumit të energjisë elektrike të cilët janë:

1. Niveli i humbjeve të energjisë elektrike në shpërndarje.
2. Niveli i arkëtimeve të energjisë elektrike së faturuar.

Humbjet e përgjithshme të raportuara nga shoqëria për vitin 2020, arrijnë në **21.48** %, duke shënuar ulje të nivelit të humbjeve krahasuar edhe me vitin 2019. Niveli total i arkëtimeve i raportuar nga OSSH sh.a. është 95.8 % kundrejt energjisë elektrike të faturuar (shih tabelën e Faturim – Arkëtimeve). Shifra e arkëtimeve përfshin edhe arkëtimet e prapambetura.



Grafiku 16: Humbjet vjetore në sistemin e shpërndarjes

Qeveria Shqiptare po vazhdon përpjekjet për një ekuilibër më të mirë midis diversifikimit të burimeve të prodhimit të energjisë, sigurisë së furnizimit me energji dhe mbrojtjes së natyrës dhe sistemit të qëndrueshëm në mënyrë që të rrisë prodhimin vendas, të zvogëlojë nivelin e humbjeve teknike dhe jo teknike të energjisë elektrike në rrjetin e shpërndarjes si dhe duke zvogëluar sasinë e energjisë së importuar për të përmbushur kërkesën për energji elektrike në vend.

Duke marrë parasysh që 99.5% e energjisë elektrike në Shqipëri prodhohet nga hidrocentralet, në vitin 2020, zbatimi i Planit të Rishikuar të Veprimit Kombëtar të Konsoliduar të Energjisë së Rinovueshme (NCREAP) 2019 - 2020, miratuar me Vendimin e Këshillit të Ministrave Nr. 580 të 28.08.2019 dhe i ndryshuar me VKM nr. 64, datë 3.2.2021 “Për një ndryshim në vendimin nr. 580, datë 28.8.2019, të Këshillit të Ministrave”, i cili përcakton qëndrimin në fuqi të NCREAP (2019-2020) gjatë vitit 2021 parashikon rritjen e kapaciteteve të instaluar bazuar në impiantet Fotovoltaik dhe eolik, si më poshtë:

- 57 MW energji hidroenergjetike;
- 490 MW energji fotovoltaike;
- 150 MW energji të erës;
- 41 MW mbeturina për energji.

NCREAP 2019–2021 merr parasysh zhvillimin e këtyre teknologjive për të siguruar arritjen e objektivit kombëtar të konsumit të BRE (38%) në 2021 dhe (42%) në 2030.

Lidhur sa me sipër, janë nënshkruar 185 kontrata koncesionare, për ndërtimin e 525 hidrocentraleve. Nga këto, 185 HEC janë në prodhim, 340 HEC janë në ndërtim e sipër ose po marrin lejet e nevojshme.

- ***Projekti Hidroenergjetik Scavica***

Qeveria Shqiptare do të ndërtojë me financim shtetëror 100% HEC Skavica, duke përfunduar skemën e shfrytëzimit të Kaskadës së lumit Drini. Ndërtimi i Hidrocentralit Skavica është një hap i rëndësishëm drejt rritjes së sigurisë energjetike, zvogëlimit të importit të energjisë elektrike dhe rritjes së efikasitetit dhe prodhimit të energjisë nga hidrocentralet e tjerë të Kaskadës së Lumit Drin. Me iniciativën e Qeverisë Shqiptare dhe me financim nga Bashkimi Evropian dhe BERZH, studimi i fizibilitetit për ndërtimin e Skavicës u përfundua me sukses. Rekomandimi kryesor i studimit mbështet alternativën e digave të larta me kapacitet të instaluar 210 MW dhe një prodhim prej 915 GWh/vit. Hidrocentrali i Skavicës, si tre hidrocentralet e tjerë në Kaskadën e lumit Drin, do të operohet nga KESH. (Korporata Elektroenergjetike Shqiptare).

Projekti i Qeverisë Shqiptare për ndërtimin e Hidrocentralit të Skavicës ka gjetur mbështetjen e Qeverisë Amerikane, e cila ka shprehur angazhimin e drejtpërdrejtë për të mbështetur Shqipërinë në këtë nismë të rëndësishme. Në kuadër të Memorandumit të Bashkëpunimit Ekonomik për Projektet dhe Blerjet, mes Qeverisë Shqiptare dhe Qeverisë Amerikane, Ministri i Infrastrukturës dhe Energjisë dhe përfaqësuesi i Bechtel, nënshkruan Memorandumin e Mirëkuptimit për Bashkëpunim lidhur me Projektin HEC Skavica. Projekti do të realizohet në 2 faza ku kontrata e fazës së parë përfshin do t'i mundësojnë Bechtelit t'i paraqesë një propozim Autoritetit Kontraktor dhe do të ndihmojë Autoritetin Kontraktor dhe Këshillin e Ministrave të Shqipërisë për të siguruar mbështetje financiare për projektin. Kontrata e fazës së dytë konsiston në projektimin dhe ndërtimin e hidrocentraleve Skavica.

Diversifikimi i prodhimit të energjisë elektrike ka avancuar më tej duke promovuar burime alternative të energjisë së rinovueshme (era dhe dielli) përmes investimeve private dhe përmes ankandeve. Persa i përket investimeve në kapacitetet e reja prodhuese të energjisë nga burimet e rinovueshme (diellore ose të erës), projektet identifikohen nga investitorët e interesuar, të cilët

kryejnë studimet përkatëse dhe i paraqesin për shqyrtim në MIE bazuar në VKM Nr. 822, datë 07.10.2015 të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e rregullave dhe procedurave të ndërtimit të kapaciteteve të reja prodhuese të energjisë elektrike, që nuk janë objekt konçesioni”, i ndryshuar, sipas së cilës energjia e prodhuar do të tregtohet në treg të lirë (Pa incentiva për kapacitete mbi 2 MW dhe perfiton nga incentivat për kapacitete deri në 2 MW).

Bazuar sa me sipër, tabela e impianteve fotovoltaike dhe eolik në prodhim dhe në proces miratimi, si më poshtë:

Tabela 8. Impiantet fotovoltaike në proces miratimi dhe në prodhim 2020

ANKANDE			
1	Karavasta	140 MW	140 MW
2	Spitallë	100 MW	100 MW
PROJEKTE FOTOVOLTAIKE DERI NË 2 MW NË PRODHIM			
12 copë (12X2 MW)			24 MW
PROJEKTE FOTOVOLTAIKE TË PAJISURA ME MIRATIM PARAPRAK			
1	1 copë	2 MW	2 MW
2	3 copë	(50 MW x3)	150 MW
3	1 copë	5.143 MW	5.143 MW
PROJEKTE EOLIKE TË PAJISURA ME MIRATIM PËRFUNDIMTAR			
3	5 copë	(3 MW x5)	15 MW
PROJEKTET EOLIKE TË PAJISURA ME MIRATIM PARAPRAK			
1	7 copë	(3 MW x7)	21 MW
Totali			457.143 MW

Skemat Mbështetëse të dhëna përmes procedurës konkurruese, bazuar në VKM 349 dt.12.06.2018 “Për miratimin e masave mbështetëse për promovimin e përdorimit të energjisë elektrike nga

burimet e rinovueshme të diellit dhe erës, si dhe procedurat për përzgjedhjen e projekteve në dobi të tyre” për të promovuar përdorimin e energjisë elektrike nga burimet e rinovueshme të diellit dhe erës sigurohen përmes një procesi konkurrues, të hapur, transparent dhe jodiskriminues që siguron besueshmëri për pjesëmarrësit dhe garanton sigurimin e këtyre masave për subjektet që ofrojnë kushtet më të mira në lidhje me çmimin e energjisë, teknologjinë e përdorur dhe mënyrën e ndërtimit të impiantit.

Bazuar sa me sipër janë në proces ankandet si me poshtë vijon:

- ***Impianti fotovoltaik i Karavastasë***

Bazuar në Vendimin e Këshillit të Ministrave Nr. 349 të datës 12.06.2018 dhe objektivat e Planit Kombëtar të Veprimit të Rinovueshëm 2019 - 2020, Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë përfundoi procedurën e tenderimit për zgjedhjen e zhvilluesit të projektit për ndërtimin e një centrali fotovoltaik në Remas - Karavasta (afër zonës së Lushnjës) me një kapacitet të instaluar 140 MW, ku 70 MW, si pjesë e masave mbështetëse (për këtë kapacitet do të ketë një PPA për 15 vjet) dhe 70 MW të cilat nuk do të jenë pjesë e Masave Mbështetëse. Ofertuesi fitues ofroi një çmim prej 24.89 euro/MWh, për 15 vjet. Në vitin 2020 u nënshkrua Marrëveshja e Zhvillimit të Projektit e cila është në fazë zbatimi dhe Marrëveshja e Blerjes së Energjisë.

- ***Impianti fotovoltaik i Spitallës, Durrës***

MIE përfundoi gjithashtu procedurën e tenderimit për ndërtimin e Impiantit Fotovoltaik Spitalla gjatë 2021, me një kapacitet të instaluar 100 MW (70 MW, si pjesë e Masave Mbështetëse dhe një shtesë prej 30 MW të cilat nuk janë pjesë e Masave Mbështetëse) në zonën e Spitallës, të rrethit të Durrësit. Fituesi ofroi çmimin prej 29.89 Euro/MWh. Marrëveshja e Zhvillimit të Projektit dhe Marrëveshja e Blerjes së Energjisë u nënshkruan në qershor 2021.

- ***Ankandi i burimeve eolike me vendndodhje të papercaktuar***

MIE ka shpallur një proces konkurrues për prodhimin e energjisë elektrike nga era me një kapacitet të instaluar nga 10 MW në 75 MW. Përmes kësaj procedure ofertimi, MIE do të përzgjedhë projekte me një kapacitet total prej 100 MW të cilët do të përfitojnë nga masat mbështetëse. Autoriteti kontraktues mund të vendosë më vonë të rrisë kapacitetin e përgjithshëm të tenderuar deri në 150 MW. Sipas kriterëve të kësaj procedure konkurruese, ofertuesit potencialë

duhet të identifikojnë dhe propozojnë vende të përshtatshme për projektimin, financimin, ndërtimin dhe funksionimin e parqeve eolike.

- **Ankandet Hibride 5-10 MW**

Përveç kësaj, MIE po përgatit zhvillimin e procedurës konkurruese për Ankandet Fotovoltaik Hibrid me kapacitet të instaluar prej 5-10 MW, për një kapacitet të përgjithshëm prej 50 MW.

- **Parashikimet për 10 vitet e ardhshme**

Ministria të Infrastrukturës dhe Energjisë, mbështetur nga Qeveria Gjermane (GIZ) dhe Sekretariati i Komunitetit të Energjisë në përmbushjen e mekanizmit të qeverisjes, po zhvillon Planin Kombëtar të Integruar të Energjisë dhe Klimës (NECP), në përputhje me Rregulloren (BE) 2018/1999) dhe detyrimet e vendit për të zbatuar Marrëveshjen e Parisit dhe Rekomandimin e Këshillit të Ministrave të Komunitetit të Energjisë 2018/01 / MC-EnC, i cili pritet të miratohet në fund të vitit 2021. Plani Kombëtar i Energjisë dhe Klimës (NECP), do të parashikojë prodhimin e pritshëm bazuar në kapacitetet e instaluara për periudhën dhjetëvjeçare nga 2021 deri në 2030 (rritjen e kapaciteteve prodhuese , uljen e konsumit final bruto të energjisë nepermjet promovimit të eficientes së energjisë, do të parashikojë disa masa në lidhje me BRE në Transport dhe % të pjesës së biokarburanteve).

Prodhuesit e pavarur nga burimet hidro janë;

- Hec Ulez me kapacitet 25,2 MW
- Hec Shkopet 24 MW
- Hec Bistrica 1 22,5 MW
- Hec Bistrica 2 5 MW
- Hec Peshqesh 2 7,940 MW
- Hec Fangu 74,6 MW
- Hec Banje 73 MW
- Hec Moglice 184 MW

5.7 Hidroenergja

Sipas raportimeve të shoqërisë KESH sh.a , viti 2020 rezulton jo i favorshëm nga pikëpamja hidrike, kjo si pasojë e thatësisrës së trashëguar që nga viti 2019, e cila pati ndikim të ndjeshëm tek prurjet dhe niveli i liqenit të HEC Fierzë, e për rrjedhojë edhe në rezervën energjetike që KESH sh.a. menaxhon në funksion të plotësimit të detyrimeve publike dhe veprimtarisë tregtare të shoqërisë KESH sha.

Në ngjashmëri me 6 mujorin e parë të vitit 2019 dhe për këtë periudhë për vitin 2020, prurjet mesatare rezultuan me 154.2 m³/sek ose pothuajse 36% më të ulta se mesatarja shumëvjeçare (për të njëjtën periudhë prej 240.4 m³/sek). Niveli mesatar i prurjeve prej rreth 155 m³/sek është pothuajse në të njëjtën vlerë me situatën analoge të 6-mujorit I (të parë) 2019, duke përsëritur pothuaj të njëjtin skenar situatë hidro-meteorologjik si të 2019. Një përmirësim u evidentua me reshjet lokale gjatë muajit Mars, që rezultoi me një rritje të prurjeve në Fierzë në 253 m³/sek

Në muajin Janar ishte 271.6 m, thënë ndryshe rreth 5 m më i ulët se referenca shumëvjeçare 1993-2019, kjo si pasojë e situatës jo të favorëshme hidrologjike të trashëguar edhe nga viti 2019. Në fund të muajit Qershor 2020 niveli i Fierzë rezulton 291.66 m ose +2.55 m më i lartë se niveli referues shumëvjeçar 1993-2019, prej 289.11 m. Në muajin Qershor 2020, KESH rriti prodhimin nga HECet e kaskadës dhe gjeneroi për nevojat e klientëve fundorë 286 GWh. Në Korrik, Gusht dhe Shtator rezultuan me prurje më të ulta, në krahasim të muajve të tjerë në vite dhe me mestaren shumëvjeçare.

Prodhimi bruto i energjisë elektrike nga HEC-et e Kaskadës së Drinit në 6-mujorin e parë ishte 1,327 GWh ose 44 % më pak se prodhimi mesatar shumëvjeçar për të njëjtën periudhë të vitit. Gjatë muajit Tetor kishte një rritje të ndjeshme të prurjeve me 22 % në krahasim me mesatren shumëvjeçare, e cila u reflektua dhe mebprodhimin me rreth 343 GWh. Ndërkohë edhe në muajt Nëntor dhe Dhjetor situata hidrike vijoi me prurjet respektivisht 70% dhe 50% më pak se mestarja e prurjeve shumëvjeçare e cila u reflektua me prodhim respektivisht 239 GWh dhe 227 GWh.

Tabela 9. Shfrytëzimi i Kapacitetit gjenerues të Centraleve.

TE DHENAT PER SHFRYTEZIMIN E KAPACITETEVE GJENERUESE PER VITIN 2020					
HEC	Prodhimi	Fuqia mes.lejvar per Agregat (MW)	Koef.mes.ngark .Agregatit (%)	Total ore pune	Koef.mes.shfrytz. Agregatit (%)
Fierze	984,010	104.8	91%	10183	29%
Koman	1,429,244	150.0	78%	12243	35%
Vau Dejes	707,982	46.60	86.2%	17668	40%


Të dhënat e mësipërme tregojnë se koeficientët e shfrytëzimit për vitin 2020 kanë qënë mbi mesataren shumëvjeçare për të tre HEC-et e kaskadës së lumit Drin. Prodhiimi i energjisë elektrike i realizuar nga centralet prodhuese private për vitin 2020 është 2,979,252 MWh ose rreth 42 % e prodhimit total vendas. Për vitin 2020, numri i centraleve prodhuese private të cilat kanë prodhuar energji elektrike është 216, ku 8 prej tyre janë prodhues të pavarur të cilët zotërohen nga 3 subjekte të liçensuara, kurse pjesa tjetër prej 208 centrale janë prodhues me përparësi të energjisë elektrike të cilët zotërohen nga 155 subjekte në aktivitetin e prodhimit të energjisë elektrike. Në total, kapaciteti i instaluar i centraleve prodhuese private është 1,058 MW, ku kapaciteti i instaluar i centraleve të prodhuesve të pavarur është 436 MW, kurse 622 MW i përket centraleve të prodhuesve më përparësi të energjisë elektrike.

Prodhiimi vjetor neto i energjisë elektrike nga impiantet të cilat kanë hyrë në prodhim gjatë vitit 2020. Siç shihet përgjatë vitit 2020 kanë hyrë në prodhim gjithsej 20 impiante me një fuqi të instaluar prej 227.8 MW, të cilët kanë prodhuar gjatë vitit 2020 sasinë prej 182,816 MWh. Prodhiimi i energjisë elektrike i realizuar nga impiantet që kanë hyrë në prodhim gjatë vitit 2020 zë rreth 3.44 % të prodhimit total vendas të energjisë elektrike për këtë vit.

Fuqia e instaluar e centraleve të lidhur në sistemin e transmetimit për vitin 2020 është 2,200 MW. Prodhiimi total i energjisë elektrike nga këto centrale është 4,712,074 MWh. Fuqia e instaluar e centraleve të lidhura në rrjetin e shpërndarjes është 306 MW. Kjo fuqi e instaluar e centraleve në rrjetin e shpërndarjes përbëhet nga 285 MW fuqi e instaluar në burime Hidrike dhe 21 MW fuqi e instaluar në impiante fotovoltaike. Prodhiimi i realizuar nga centralet hidrike të lidhura në rrjetin e shpërndarjes gjatë vitit 2020 është në sasinë 568,693 MWh, ndërsa prodhiimi i realizuar nga impiantet fotovoltaike është në sasinë 32,265 MWh.


5.8 Energjia e Rinovueshme në Bilancin e Energjisë

Për vitin 2020 burimet e rinovueshme kanë patur një kontribut prej 33.37 % me një ulje rreth 3 % krahasuar me vitin 2019, kjo ulje ishte si pasojë e sasisë së ulët reshjeve të vitit 2020. Energjia hidrike vazhdon të dominojë në burimet e rinovueshme ndërsa burimet e tjera të rinovueshme me përjashtim të biomasës (drutë e zjarrit) dhe biokarburanteve, kanë një rol të moderuar në kontributin e tyre. Energjia diellore për vitin 2020 përveç prodhimit të ujit të ngrohtë ka filluar të përdoret dhe për prodhimin e energjisë elektrike si pasojë e venjes në punë të 10 parqeve fotovoltaike.



Grafiku 17: Ecuria aktuale e kontributit të RES në Shqipëri

Politikat e energjisë së rinovueshme pas miratimit të ligjit të shfuqizuar 138/2013 dhe ligjit aktual 7/2017, deri sot, përbëhen nga dy Planet Kombëtare të Veprimit për BRE-të, (2015–2020) dhe (2018–2020) të cilat në implementimin e tyre po ndikojnë në stabilizimin e targetit kombëtar të burimeve të rinovueshme për të arritur vlerën 38%.



Grafiku 18: Ecuria e prodhimit të burimeve të rinovueshme (TJ)

5.9 Drutë e Zjarrit

Drutë e zjarrit janë një burim i rëndësishëm energjie, të cilët kanë dhënë dhe vazhdojnë të japin kontribut të ndjeshëm në bilancin energjetik shqiptar, në plotësimin e nevojave për ngrohje, ujë të ngrohtë dhe gatim. Në vitin 2020, rezulton që 93% e druve të zjarrit janë konsumuar në sektorin e banesave dhe vetëm një pjesë e vogël në sektorin e shërbimeve dhe të industrisë. Krahëuar me periudhën e viteve të kaluara, vihet re që struktura e konsumit të druve të zjarrit sipas sektorëve ka ruajtur të njëjtin tipar, atë të përdorimit të tyre në sektorin e banesave.

Vlen të përmendim gjatë vitit 2020 vendi ynë ka importuar dru zjarri për konsum energjie si dhe për prodhimin e peletave. Aktualisht në vendin tonë ka 6 fabrika që prodhojnë peletat të cilat kryesisht i eksportojnë dhe fare pak qëndrojnë te konsumatorët tanë. Konsumi i druve të zjarrit edhe në vitin 2020 është 160 Ktoe (i llogaritur) me një rritje, 3 ktoe karahasuar me vitin 2019.

5.10 Biokarburantet

Biokarburantet të mbështetura në ligjin nr. 9876/2008 “Për prodhimin, transportimin dhe tregëtimin e bio-karburanteve dhe të lëndëve të para djegëse, të rinovueshme, për transport” vazhdojnë të rrisin kontributin e tyre në konsumin final të energjisë për vitin 2020. Sasia e përzier me biodiezel ka qenë 120 ktoe.

5.11 Energjia Diellore

Në Shqipëri rrezatimi diellor vjetor është i lartë dhe teorikisht mund të sigurojnë një ngrohje të nevojshme me temperaturë të ulët gjatë gjysmës së vitit. Gjithsesi panelet diellore të disponueshëm në tregjet shqiptare pjesërisht ndihmohen nga energjia elektrike, vecanërisht gjatë periudhës nëntor-mars. Në këtë kuadër Shqipëria ka bërë gjithashtu progres të dukshëm ku sipas vlerësimeve sipërfaqja kumulative e sistemeve të prodhimit të ujit të ngrohtë nga rrezatimi diellor është 24,5m²/1000 banorë. Për vitin 2020 energjia diellore e konsumuar për ujë të ngrohtë është 13.46 ktoe.

Gjatë vitit 2020 kanë hyrë në prodhim subjektet e mëposhtme, të cilat realizojnë prodhim të energjisë elektrike nga centrale fotovoltaike.

Tabela 10. Subjektet që prodhojnë energji nga centralet fotovoltaike 2020

	PRODHIMI NGA CENT FOTOVOLTAIKE TE LIDHURA ME RRJETIN E SHPERNDARJES (MWh) 2020				
	CENTRAL FOTOVOLTAIK	MW	SUBJEKTI	LIDHJA	PROG. 2020
PPE	UKKO (pa sistemuar ne sistem)	1	"UKKO sh.a (Ujsjell. Kanal. Korce)	35 kV	
PPE	SEMAN-2	2	"SEMAN N2SUN" sh.p.k	35 kV	4,119
PPE	TOPOJE	2	"SONNE" sh.p.k	35 kV	4,095
PPE	TOPOJE 2	2	"AED SOLAR" sh.p.k	35 kV	4,088
PPE	TOPOJE (SHEQ MARINAS)	2	"AGE SUNPOWER" sh.p.k	35 kV	4,100
PPE	TOPOJE (SHEQ MARINAS) 2	2	"SEMAN SUNPOWER" sh.p.k	35 kV	4,124
PPE	SEMAN SOLAR	2	"SEMAN1 SOLAR" sh.p.k	35 kV	4,079
PPE	ES 2019 sh.p.k	2	"ES 2019" sh.p.k	35 kV	244
PPE	SMART WATT sh.p.k	2	"SMART WATT" sh.p.k	35 kV	243
PPE	TREN BILISHT	2	"RTS" sh.p.k	35 kV	3,228
PPE	PLUG LUSHNJE	2	"AEE" sh.p.k	10 kV	3,946
	TOTAL MUJOR				32,265

5.12 Energjia e erës

Shqipëria ka potencial për energjinë e erës, por teknologjia nuk është zhvilluar. Megjithatë, ka plane për zhvillimin e projekteve për shfrytëzimin e erës në vitet e ardhshme. Potenciali i energjisë së erës në vendin tonë është rreth 2000 MW. Era gjeneron fuqi mekanike nëpër turbinat e erës. Ultësirat bregdetare dhe Jugore, Lindore, si dhe malet në Veri të Shqipërisë janë zona të mira për turbinat e erës. Megjithatë, ekzistojnë edhe pengesat të cilat marrin pjesë në zgjedhjen e një lokacioni, duke përfshirë: lartësia, qasja e vendit, infrastruktura, zonat e mbrojtura, dhe rrjeti i energjisë. Shpejtësia e erës është 8–9 m/s në shumë zona të Shqipërisë.

Shfrytëzimi i energjisë së erës në vendin tonë nuk ka filluar ende, por ka një shprehje shumë të madhe interesi nga investitorët e huaj. Në këtë kuadër, janë në studim disa rajone të vendit tonë nga disa kompani të huaja të cilat synojnë të ndërtojnë parqe eolike për prodhimin e energjisë elektrike.

6. TRANSFORMIMI

6.1 Energjia Hidrike

Për vitin 2020 prodhimi i energjisë elektrike nga hidrocentralet arriti një prodhim bruto në vlerën 456.93 ktoe dhe një prodhim neto në vlerën 448.01 ktoe me humbje 4.5%.


6.2 Rafineritë

Per vitin 2020 rafineritë kanë punuar në mënyrë periodike, duke përpunuar rreth 134.37 ktoe ku 85% të saj e ka përpunuar rafineria e Ballshit me një humbjet teknologjike 0.4%. Sektori i rafinimit të naftës bruto vazhdon të përballet me vështirësi serioze, si pasojë e problemeve ekonomike të shoqërisë që administron këtë sektor. Vlen të theksojmë se rafineritë tona kanë probleme serioze në kontrollin e ndotjeve mjedisore, për shkak të mungesës së investimeve në këtë sektor pasi teknologjia e përdorur është e vjetër dhe e amortizuar.

7. KONSUMI

7.1 Sektori i industrisë

Bilanci i energjisë, sektorin e industrisë e paraqet të ndarë në 10 nënsektorët si më poshtë: metalurgji, kimi, materiale ndërtimi, miniera, ushqim/pije/duhan, tekstil/lëkure/këpuce, dru/letër/stampim, mekanike dhe të tjera. Konsumi i energjisë në këta nënsektorë është përqëndruar në vënien në punë të paisjeve motorike si dhe për procese teknologjike. Në vendin tonë konsumatorë të lartë të energjisë në këta nën sektorë janë industria e materialeve të ndërtimit si dhe industria metalurgjike.




Grafiku 19: Ecuria e konsumit sipas sektorëve të ekonomisë (Ktoe)

Për vitin 2020 ecuria e konsumit ka një ulje si pasojë e situatës pandemike ku sektori i transportit dhe i shërbimeve kanë një ulje të ndjeshme krahasuar me vitin 2019 përkatësisht 232.36 ktoe dhe 28.12 ktoe.


7.2 Sektori i transportit

Nga të dhënat e sektorit të transportit në Shqipëri shihen tendenca në rritje të aktiviteteve të tij, në drejtim të shpërndarjes së peshës në aktivitetet e tij që synon t'i përgjigjet sfidës globale për zbutjen e ndryshimeve klimatike. Vlen të theksojmë që sektori i transportit në Shqipëri duhet të zbatojë masat të rrepta që përmirësojnë në mënyrë të konsiderueshme eficiencën e energjisë si dhe për t'i hapur rrugën uljes së emetimeve që vijnë nga ky sektor.



Grafiku 20: Ecuria e konsumit të produkteve të naftës sipas sektoreve, (ktoe)

Spektori i transporti në Shqipëri vazhdon ritmin e ritjes në masën 2.5-3% duke patur një peshe më të lartë në konsumin e lëndëve energjetike në masën 42%. Ndikim në këtë zhvillim ka përmirësimi i infrastrukturës rrugore e cila ka rritur numrin e automjeteve, duke rritur ngarkesën totale të trafikut nga viti në vit. Për vitin 2020 numri i automjeteve arriti në 676,811 nga 627,355 mjete që kishte viti 2019. Për vitin 2020 konsumi i këtij sektori në të gjitha aktivitetet e tij është 627.41 ktoe me një ulje krahasuar me vitin 2019 prej 232.36 ktoe, ku pjesën dërmuese të konsumit vazhdon ta ketë transporti rrugor në kontrast me transportin hekurudhor dhe transportin ujor. Kjo ulje e ndjeshme e konsumit në transport është si pasojë e masave anti covid që ka ndërmarrë Qeveria gjatë vitit 2020.



Grafiku 21: Ecuria e numrit te automjeteve

7.3 Sektori i banesave

Konsumi i energjisë në sektorin e banesave përfshin një mori shërbimesh energjetike përfshirë ngrohjen e hapësirave, kondicionimin e ajrit, ujin e ngrohtë, gatimin, ndriçimin dhe pajisjet elektroshtëpiake. Nga analiza e të dhënave të bilancit energjetik vazhdon konsumi drejt përdorimit të energjisë elektrike për ngrohjen e hapësirave krahasuar me lëndët e tjera energjetike si drutë e zjarrit dhe LPG.

Kërkesa për energji nga sektori i banesave përbën një sfidë të madhe për vendin tonë pasi ky sektor konsumon 55% të konsumit kombëtar të energjisë elektrike. Vlen të theksojmë se në zonat rurale vazhdon konsumi i druve të zjarrit për ngrohje dhe gatim.

Sektori i banesave zë vendin e dytë në sasinë e konsumit final të energjisë në Shqipëri, pas transportit me një peshë specifike prej 29%. Për vitin 2020 në këtë sektor shihen tendenca për një konsum eficient të energjisë si pasojë e kontrollit të energjisë elektrike e cila ka peshën kryesore të lëndeve energjetike. Për vitin 2020 konsumi i energjisë në këtë sektor është 527.71 ktoe ndërsa për vitin 2019 ishte 492 ktoe.

7.4 Sektori i shërbimeve

Sektori i shërbimeve ndahet në dy nënsektore: shërbimet publike dhe shërbimet private. Ky sektor në vlerësimet tona është kategorizuar së bashku me sektorin publik dhe aktivitetin tregtar jo-industrial (që njihet gjithashtu si “sektori terciar”). Tradicionalisht, sektori i shërbimeve publike për të siguruar ngrohjen, mbështetet tek konsumi i energjisë elektrike dhe i druve të zjarrit.

Në analizën e bilancit energjetik të vitit 2019 u vlerësuan 9.1 milionë m² sipërfaqe e përgjithëshme grupit të llojeve kryesore të ndërtesave publike, shifër që nuk pritet të ndryshojë në mënyrë të konsiderueshme.

Ashtu si në sektorin e banesave, përqindja e konsumit final të energjisë në sektorin e shërbimeve ka mbetur e qëndrueshme, duke zënë 9% të të gjithë konsumit final të energjisë. Kjo është në kontrast me pritshmëritë e zhvillimit të këtij sektori, që parashikon një rritje me të shpejtë por është diktuar nga zhvillimi ekonomik i vendit tonë.

Në terma absolute, konsumi i energjisë në këtë sektor ishte 3.6 % më i ulët se në vitin 2019 , me një vlerë prej 190.12 ktoe.

7.5 Sektori i bujqësisë

Të dhënat nga INSTAT tregojnë se në fund të 2020-s, pesha e bujqësisë ndaj totalit të ekonomisë arriti në 19.3% të Prodhimit të Brendshëm Bruto, nga 18.4% në dy vitet e mëparshme. Gjatë dekadës së fundit, pavarësisht një sërë problemesh strukturore, sektori ka patur një rritje të moderuar. Zgjerimi i sektorit, gjatë periudhës 1999-2020, mendohet të ketë kontribuar në performancën e përgjithshme të ekonomisë në vend. Përveç kësaj, rritja e çmimeve të produkteve bujqësore në tregjet botërore përcjell stimujt e duhur për rritjen afatgjatë të prodhimit të kësaj dege të ekonomisë shqiptare. Për më tepër, zhvillimet dhe reformat strukturore (që synojnë rritjen e efijencës në prodhimin bujqësor, lehtësimin e aksesit të produkteve bujqësore në tregun e brendshëm dhe tregjet e huaja, si dhe mbështetjen financiare të bizneseve dhe fermave të këtij sektori) janë konsideruar si një prioritet i politikave ekonomike të ardhshme.

Parë në aspektin e konsumit të energjisë sektori i bujqësisë ku futet edhe peshkimi në bilalcin e konsumit të energjisë për vitin 2020 zë një peshë 6.5%. Parë në kontributin e këtij sektori në ekonominë shqiptare ky sektor vazhdon të ecë me ritme të ngadaltë në modernizimin e tij. Për vitin 2020 konsumi i këtij sektori ishte në vlerën 116.24 ktoe.

8. ANEKS Bilanci Energjetik 2020

	Year 2020	TOTAL	Solid fuels	Natural Gas	Crude, NGL and Feedstock	Biomass (Fuelwood)	Hydro & Electricity	Solar Energy	Derived Heat
	Primary production	1480.35	42.06	49.2	758.17	155	456.93	13.46	5.5
	Recovered products	0.00			0.0				
	Imports (Pet Prod+ Electricity)	1497.85	92.08		1113.55	13.700	278.52		
	Stock change	69.70			69.70				
	Exports	822.12			730.60	8.700	82.82		
	Bunkers	31.00			31.00				
	Gross inland consumption	2055.38	134.14	49.2	1040.42	160.00	652.63	13.46	5.50
	Transformation input	591.30			134.37		456.93		
	Classic thermal Power Stations	0.00			0		0		
	Public Hydro power stations	456.93					456.93		
	Autoprod. thermal power stations	0.00			0.00		0		
	Nuclear power stations	0.00							
	Patent fuel and briquetting plants	0.00							
	Coke-oven plants	0.00							
	Blast-furnace plants	0.00							
	Gas works	0.00							
	Refineries	134.37			134.37				
	District heating plants	0.00							
	Transformation output	785.04	0	0	131.01	0	652.63	0.00	1.4
	Classic thermal Power Stations	0.00					0.00		
	Public Hydro power stations	448.01					448.01		
	Autoprod. thermal power stations	0.00							
	Nuclear power stations	0.00							
	Patent fuel and briquetting plants	0.00							
	Coke-oven plants	0.00							
	Blast-furnace plants	0.00							
	Gas works	0.00							
	Refineries	132.41			131.01				1.4
	District heating plants	0.00	0						
	Exchanges and transfers, returns	0.00			3.36				
	Interproduct transfers	0.00							
	Products transferred	0.00							
	Returns from petrochem. industry	0.00							
	Transformation Losses	16.46	0	0	7.34	0	8.92	0.00	0.2
	Consumption of the energy branch	89.13	0	42.0	17.87	0	29.23	0	0
	Production and distribution of electricity	10.20					10.20		
	Pumped storage stations	0.00							
	District heating plants	0.00							
	Extraction and aggl. of solid fuels	8.43					8.43		
	Coke-oven and gas works plants	0.00							
	Oil and Nat. Gat extraction plants	50.63		42.0	2.80		5.80		
	Oil & Gas pipelines	0.00			0				
	Oil refineries	19.87		0.0	15.07		4.80		
	Nuclear fuel fabrication plants	0.00							
	Distribution losses (humbje jo tekn ne shpermd)	71.29	0	0	0	0	71.29		0.00
	Available for final consumption	1877.30	134.14	7.2	1015.21	160.00	543.20	13.46	4.10
	Final non-energy consumption	31.29		0.0	31.29				
	Chemical industry	0.54			0.54				
	Other sectors	30.75		0.0	30.75				
	Final energy consumption	1845.47	134.1	7.2	983.4	160.00	543.20	13.46	4.1
	Industry	387.89	130.44	7.2	120.19	7.5	117.36	1.10	4.1
	Iron & steel industry	30.64			3.05		27.59		
	Non-ferrous metal industry	4.42			0.00		4.42		
	Chemical industry	13.92			7.89		6.03		
	Glass, pottery & building mat. industry	219.53	122.74		74.77	2.4	19.62		
	Ore-extraction industry	20.69			3.20		17.48		
	Food, drink & tobacco industry	54.90		7.2	17.41	5.1	19.98	1.10	4.1
	Textile, leather & clothing industry	15.00			2.82		12.18		
	Paper and printing	7.13			0.96		6.17		
	Engineering & other metal industry	4.76			0.88		3.88		
	Other industries	16.90	7.7		9.20		0.00		0.00
	Transport	627.41	0	0.00	627.04	0.00	0.37	0.00	0
	Railways	2.10			2.10				
	Road transport	576.41			576.04		0.37		
	Air transport	15.80			15.80				
	Inland navigation	33.10			33.10				
	Households, commerce, pub. auth., etc.	717.83	3.7	0.00	148.15	140.1	413.52	12.36	0.00
	Households	527.71	0		100.12	121.45	298.34	7.80	
	Agriculture	74.93			53.68	12.4	8.85		
	Fisheries	41.31			38.21		3.10		
	Other	0.00			0.00				

48